



**MISIONI NDËRKOMBËTAR PËR VËZHGININ E  
ZGJEDHJEVE  
ZGJEDHJE PARLAMENTARE,  
ISH REPUBLIKA JUGOSLLAVE E MAQEDONISË,  
1 QERSHOR 2008**

---

**DEKLARATË PËR REZULTATET DHE KONKLuzionET PRELIMINARE**

**Shkup, 2 qershor 2008** – Misioni ndërkombëtar për vëzhgimin e zgjedhjeve (MNVZ) për zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 1 qershorit në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë është një ndërmarrje e përbashkët mes OSBE Zyrës për Institucionet Demokratike dhe të drejtat e njeriut (OSBE/ODIHR) dhe Asambleja Parlamentare e OSBE (OSBE AP) dhe Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës (APKE).

MNVZ bëri vlerësimin e zgjedhjeve të parakohshme të 1 qershorit në Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, në bazë të standardeve të organizatave përkatëse dhe përkushtimit për zgjedhje demokratike, si dhe respektimin e ligjeve nacionale. Ky raport është dhënë para publikimit të rezultateve përfundimtare, si dhe skadimit të afateve për ankesa dhe parashtrësia. Vlerësimi përfundimtar i zgjedhjeve do të varet, pjesërisht, nga realizimi i fazave të mbetura të procesit, dhe raporti i plotë përfundimtar do të lëshohet nga APKE dhe OSCE/ODIHR.

Institucionet e përfaqësuara pranë MNVZ i falënderojnë autoritetet e ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë për bashkëpunimin e tyre dhe mbesin të gatshme edhe më tej të vazhdojnë me mbështetjen për ta dhe shoqërinë civile në zbatimin e zgjedhjeve demokratike.

---

**KONKLuzionET PRELIMINARE**

---

Me 1 qershor zgjedhjet parlamentare votuesve iu ofruan një llojllojshmëri zgjedhjesh gjatë një fushate të zhvilluar në mënyrë shumë energjike. Zgjedhjet u drejtuan mirë nga ana procedurale. Megjithatë, pritjet për një progres nuk u arritën për shkak të dështimit të parandalohen aktet e dhunshme në rajonet etnike shqiptare si dhe zbatimi i kufizuar dhe i pjesshëm i ligjit. Përpjekjet e organizuara për të penguar procesin zgjedhor në orët e mëngjesit gjatë ditës të votimit pamundësoi shumë qytetarë në shumë vende të shprehin lirisht vullnetin e tyre. Gjendja e sigurisë u stabilizua deri diku më vonë gjatë ditës. Gjendja e sigurisë u stabilizua deri diku gjatë ditës. Megjithëse pritjet e OSBE dhe KE nuk u plotësuan, vlerësimi i përgjithshëm do të varet nga pjesërisht nga ajo nëse autoritetet do të zbatojnë hetim të thellë të shkeljeve serioze të ligjit dhe masat që do t'i marrin kundër tyre. OSBE/ODIHR do të vazhdojnë të vëzhgojnë procesin, si dhe përsëritjet e mundshme të votimit.

Dita e zgjedhjeve u trazua me incidente të dhunshme, frikësime dhe mbushje të kutive për votim në rajonet e banuara kryesisht me Shqiptarë etnik<sup>1</sup>. Megjithëse gjendja e sigurisë u stabilizua gjatë ditës në këto rajone, incidentet e mëngjesit shkaktuan vdekjen e një personi dhe disa të tjerë

---

<sup>1</sup> Veçanërisht në komunat e Tetovës, Gostivarit, Vrapçishtës, Bërvenicës, Bogovinjes, Tearces, Zajazit, Dibrës, Cairit, Sarajit, Cucer-Sandevës dhe Haraqinës.

u plagosën. Procesi ishte më pak pozitiv gjatë numërimit të votave me 15 për qind të numërimit që u vlerësua si i keq ose shumë keq mbarë vendit.

Gjatë ditës të zgjedhjeve, Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve (KKZ) anuloi rezultatet në 22 vendvotime në pjesën veriore dhe perëndimore të vendit. KKZ deklaroi se anulime të tjera janë të ngjashme dhe autoritetet shtetërore premtuan të sigurojnë rivotime në rajonet ku ndodhën incidente të rënda.

Përkundër faktit se autoritetet qeveritare dhe e shumta e partive politike theksuan përkushtimin ndaj sigurimit të zgjedhjeve demokratike, pa dhunë dhe kërcënime, tensionimet mbetën të larta mbarë rajoneve të banuara kryesisht me Shqiptarë gjatë periudhës parazgjedhore. Kjo rezultoi me frikësim të votuesve dhe autoriteteve zgjedhore, disa nga të cilët kërkuan që të liroheshin nga detyra duke dhënë si arsye frikën nga dhuna në ditën e votimit. Situata në pjesën tjetër të vendit ishte shumë më e qetë, megjithëse me retorikë të ashpër por pak incidente të raportuara.

Partitë ishin të lira të zhvillojnë fushatat, me përjashtim të disa rajoneve shqiptare etnike. Kërcënime me dhunë ose bllokadat nga aktivistët lokal të partive etnike shqiptare, që penguan fushatën në disa raste. Fushata e Lidhjes Social Demokrate të Maqedonisë (LSDM), partia më e madhe opozitare u manipulua nga aktivitetet e një partie me emër të ngjashëm. Në këtë kontekst, akoma hetohet nëse kandidatët e partive të tyre kanë dhënë pajtimin për të qenë në listat e kandidatëve. Fushatat reklamuese qeveritare u dhanë një avantazh plotësues partive të koalicionit në pushtet.

Shërbimet e mediave siguruan platforma të ndryshme për paraqitjen e qëndrimeve të kandidatëve dhe fushatave, që iu mundësuan votuesve të informohen për të bërë zgjedhjen e tyre. Por, ato nuk i trajtuan të gjitha partitë në mënyrë të barabartë. Televizioni publik dëshmoi njëanshmëri në lajmet duke iu dhënë më shumë hapësirë partive në pushtet. Disa media private ofruan raporte informative të balancuara, dhe kishte të tjera që ishin qartë të njëanshëm.

Gjatë ditës zgjedhore KShZ anuloi rezultatet në 22 vendvotime në pjesën veriperëndimore të vendit. KShZ deklaroi se ka gjasa të ketë anulime të tjera, ndërsa autoritetet shtetërore premtuan se to të siguroj mbajtjen e rivotimit aty ku ndodhën incidente të rënda.

Tipare të tjera që karakterizuan procesin zgjedhor:

- KShZ punoi kryesisht në mënyrë transparente dhe efikase, duke respektuar të shumtën e afateve përkundër kornizës të ngushtë kohore dhe zgjedhjeve të paplanifikuara. KShZ reagoi shpejt ndaj afisheve të rrejshme të cilat u shfaqën një ditë para zgjedhjeve.
- Seleksionimi i rastësishëm dhe trajnimi i të gjithë anëtarëve të Këshillave Zgjedhorë nga radhët e nëpunësve shtetërorë, rezultuan me profesionalizimin e mëtijshëm të administratës zgjedhore.
- Barazia gjinore në listat e kandidatëve dhe administratës zgjedhore vazhdon të përmirësohet.
- Shumë komunitete etnike janë përfaqësuar nga parti politike etnike dhe shumë nga to u janë bashkangjitur koalicioneve të mëdha, që iu mundëson ë luajnë një rol politik potencialisht më të fortë.
- Numër i madh i vëzhguesve vendorë kontribuuan drejt transparencës të procesit

zgjedhor.

Njëkohësisht, u vërejtën këto mangësi plotësuese:

- Në periudhën parazgjedhore pjesëmarrësit në zgjedhje kishin qasje të kufizuar ndaj masave ligjore kundër shkeljeve të supozuara.
- Në disa vende, fakti se lista e zgjedhësve përmban shumë më tepër emra se që ka banorë shtron dyshime rreth cilësisë të saj. Nuk është zbatuar fare një rishikim i detajuar i listës zgjedhore.
- Në shumë raste nuk u zhvilluan hetime rreth sulmeve mbi zyrat e shtabeve zgjedhore, që krijoi bindjen për mosndëshkimin e atyre që kryejnë krime në lidhje me zgjedhjet.
- Këshilli i Radiodifuzionit dështoi në trajtimin efektiv të qasjes së drejtë në media sepse Parlamenti nuk miratoi udhëzimet rregullatorë për emetim gjatë fushatës.

---

## REZULTATE PRELIMINARE

---

### Historiati

Në pajtim me Kushtetutën, Parlamenti votoi shpërbërjen e vet më 12 prill 2008 dhe shpalli zgjedhje të parakohshme të cilat i caktoi me 1 qershor 2008. Vendimi u soll pasi që Bashkimi Demokratik për Integritet (BDI) deklaroi se zgjedhjet e reja nevojiten që t'i vihet fund bllokadën në Parlament. Ky hap u mbështet nga partitë qeveritare, Organizata e Brendshme Revolucionare Maqedonase – Partia Demokratike për Unitetin Kombëtar Maqedonas (VMRO-DPMNE) dhe Partia Demokratike Shqiptare (PDSH). Ky vendim u kundërshtua nga partitë tjera opozitare siç janë, LSDM dhe Partia Liberal Demokrate (PLD), si dhe nga disa partnerë koalicioni të ish qeverisë, që thanë se kjo do të shtynte edhe më shumë reformat e nevojshme të shtruar si kusht nga BE për fillimin e negociatave për anëtarësim.

Mungesa e shumicës të kualifikuar në legjislativin, sfidat në procesin e integritit në BE dhe NATO, çështja e pazgjedhur me emrin kushtetues dhe obstrukcionet ndaj punës ligjdhënëse ishin gjithashtu faktorë të cilat u vlerësuan si arsye për mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme.

Këto zgjedhje u zhvilluan për 120 vende në parlament përmes një sistemi proporcional në 6 njësi (20 vende në njësi).

### Korniza ligjore

Korniza ligjdhënëse zgjedhore është kryesisht pjesë e Kodit Zgjedhor, i cili hyri në fuqi në vitin 2006 dhe nuk është ndryshuar që nga miratimi i tij. Ligji siguron baza kryesisht të shëndosha dhe të barabarta për mbajtjen e zgjedhjeve demokratike, megjithëse përmban disa dispozita të pakompletuara dhe që nuk qëndrojnë.

Para ca kohësh u miratuan disa ligje të cilat e prekin procesin zgjedhor dhe, në disa raste, nuk janë në përputhshmëri me Kodin Zgjedhor. Dallimi më i madh ka të bëjë me ligjin që rregullon apelet. Sipas Kodit, apelet në lidhje me disa vendime të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve (KShZ) i dorëzohen Gjyqit Suprem. Ndërsa Ligji për Gjyqet Administrative, i miratuar para ca kohësh, kompetencat nga administrata zgjedhore i transferon në Gjykatën e re administrative.

Vendimi i KShZ për t'i deleguar të gjitha ankesat Gjykatës Kushtetuese, u aprovua nga organet shtetërore dhe pjesëmarrësit në procesin zgjedhor. Interpretimi i ngushtë i gjykatës në lidhje me kompetencat e tij përjashtoi ankesat që nuk kanë të bëjnë drejtpërdrejt me Kodin, që krijon boshllëk në mbrojtjen e të drejtave të garuesve zgjedhor.<sup>2</sup>

### **Administrata zgjedhore**

Kodi Zgjedhor parasheh administratës zgjedhore me tri shtylla e drejtuar nga KShZ me 85 Komisione Komunale Zgjedhore (KKZ) dhe nga një Këshill Zgjedhor (KZ) për të gjitha 2,976 vendvotime.

KShZ ka punuar kryesisht në mënyrë transparente, efikase dhe profesionale dhe arriti që t'i respektoj pothuajse të gjitha afatet. Të gjitha seancat formale të KShZ si dhe shumë mbledhje pune ishin të hapura për vëzhguesit e vendit dhe të huaj. Kishte debate të gjata rreth disa çështjeve të rëndësishme dhe KShZ përfshiu të gjithë garuesit në zgjedhje.

Për dallim nga viti 2006, të gjithë anëtarët e KKZ dhe KZ emërohen nga radhët e nëpunësve shtetërorë dhe ndërmarrjeve publike. Si rezultat i ndryshimit të këtij kriteri të seleksionimit, mbi 40% të anëtarëve të KZ duhej të zëvendësohen në këto zgjedhje. Megjithatë, KKZ zhvilloi trajnim për të gjithë anëtarët. Përbërja e tashme e KKZve dhe KZve u vlerësua se ka kontribuar në rritjen e besimit në profesionalizmin e KZve dhe KKZve.

KKZ filloi të mbante mbledhjet vetëm dy javë para mbajtjes të zgjedhjeve, kryesisht për shkak të faktit se para kësaj nuk u liruan nga detyrat e tyre të nëpunësve shtetëror. Udhëzimet e rrepta për përfaqësimin e drejtë etnik dhe gjinor, bëri që në shumë raste njerëzit të dërgohen në vende jashtë komunave të tyre. Kjo bëri që nganjëherë të pengohet komunikimi në komunat ku jo të gjithë anëtarët flisnin gjuhën në të cilën zhvilloheshin takimet.

Disa nga anëtarët në e KZ në vende me tension të lartë politik kërkuan që të liroheshin nga detyra e tyre para zgjedhjeve, duke thënë se kishin frikë nga dhuna e mundshme në ditën e zgjedhjeve. Në Tetovë për shembull, 50 individ, përfshi këtu 10 kryetarë të këshillave zgjedhore, kërkuan që të lirohen për arsye shëndetësore. Në Bërvenicë në rajonin e njëjtë, 5 nga 18 Këshillat Zgjedhorë thanë se refuzojnë të punojnë në ditën e zgjedhjeve nëse policia nuk është e pranishme gjithë kohën në vendvotim – gjë që nuk e parasheh ligji.

Një grup i KShZ udhëtoi në Tetovë dy herë që të zgjedh këtë çështje por mendonin se nuk kishin kompetencat e nevojshme për të siguruar anëtarët e KZ. Në vend të kësaj ata thanë se të punësuarit duhet të plotësojnë detyrën e tyre dhe se në të kundërtën do të përballen me përjashtim të mundshëm nga vendi i tyre i punës në shërbimin publik.

KShZ zhvilloi një fushatë të shkurtër për edukimin e votuesve në mediat nacionale duke u përqendruar në mobilizimin e votuesve, informimin e tyre se si të votojnë, dhe paralajmërim që të mos kryejnë shkelje të procesit zgjedhor. Veç kësaj, gjithashtu zhvilluan fushata intensive për edukimin e votuesve në televizion dhe përmes fletushkave.

---

<sup>2</sup>Kodi Zgjedhor jep raste specifike për të cilët garuesit zgjedhor mund të ankohen. Nëse ligji lexohet në mënyrë strikte, lejohen edhe ankesa të tjera, siç është roli i KShZ që rrjedh nga Kodi Zgjedhor që kujdeset për ligjshmërinë [e zgjedhjeve] gjatë përgatitjes dhe zbatimit të zgjedhjeve” .

## Regjistrimi i kandidatëve

Në një proces gjithëpërfshirës u regjistruan 1,540 kandidat në 18 lista. Një koalicion i udhëhequr nga partia në pushtet VMRO-DPMNE që përbëhej nga 19 parti. Koalicioni i dytë i udhëhequr nga LSDM përbëhej nga tetë parti, të cilat morën pjesë me emrin koalicioni “Dielli”. Dy partitë më të mëdha Shqiptare, BDI dhe PDSH zhvilluan fushata individuale. KShZ më 9 maj organizoi hedhjen e shortit për caktimin e vendeve në fletëvotim.

KShZ aprovoi dy lista me kandidatë të cilët janë dënuar me mbi 6 muaj burg, që është në kundërshtim me nenin 7 të Kodit Zgjedhor.<sup>3</sup>

## Regjistrimi i votuesve

Shqyrtimi dhe kontrolli publik i listave zgjedhore u bë mes 22 prillit dhe 1 majit. Megjithëse kontrollit iu dha publicitet i madh, u bënë vetëm 715 ndryshime në listat, përfshi këtu edhe fshirja e 354 personave të vdekur. Lista zgjedhore përmban gjithsej 1,779,116 votues, që shënon 2% rritje nga viti 2006.

Ministria e Drejtësisë ka për detyrë azhurnimin e listës zgjedhore nga informacionet të dhëna nga autoritetet. Nuk është zbatuar revidim i detajuar i listës. Procesi i ndryshimit të regjistrimit të vendbanimit është i gjatë, që bëri shumë njerëz mos të informojnë autoritet për zhvendosjen e tyre. Si rezultat i migrimit dhe emigrimit të brendshëm, disa lagje kanë më shumë njerëz se banorë, që shtrun dyshime rreth cilësisë të listës.

## Rrethanat e sigurisë

Rrethanat e sigurisë ndryshonin në mënyrë të konsiderueshme mes rajoneve veriore dhe perëndimore të banuara kryesisht me Shqiptarë dhe pjesën tjetër të vendit. Megjithëse autoritetet qeveritare deklaruan se do të siguronin zgjedhjeve demokratike, pa dhunë dhe frikësime dhe të gjitha partitë pjesëmarrëse në procesin zgjedhor firmosën Kodin e Sjelljes, kishte incidente të rënda të dhunshme në pjesën veriore dhe perëndimore të vendit para dhe gjatë ditës të zgjedhjeve. Kjo rriti tensionimet dhe rezultoi me frikësimin e zgjedhësve dhe zyrtarëve në administratën zgjedhore.

Policia duket se nuk arriti të parandaloj sulmet e vazhdueshme politike në rajonet Shqiptare etnike gjatë fushatës dhe aksionet si përgjigje kundër incidenteve në lidhje me fushatën ishin të kufizuara. Mes 11 dhe 26 majit, Ministria e Brendshme morri informacione për sulme kundër 14 selive partiake dhe dy zyrave rajonale të komunave gjatë fushatës.<sup>4</sup> Që nga 27 maji, nuk u bë asnjë hetim në lidhje me këto incidente, të cilat të gjitha përveç katër ishin kundër zyrave të BDI. Megjithatë, filluan katër hetime për incidente të tjera në lidhje me sigurinë. Në lidhje me incidentin e rëndë që ndodhi më 12 maj ku kolona e liderit të BDI, Ali Ahmeti u qëllua, të dyshuarit për sulmin janë arrestuar dhe presin gjykimin. Policia arrestoi tre aktivistë të BDI pas në një incident që ndodhi pas tubimit të madh të BDI në Tetovë më 29 maj, por më vonë liroi

---

<sup>3</sup> Neni 7.2 nga Kodi Zgjedhor thotë: “Çdo qytetar i Republikës së Maqedonisë ka të drejtë të zgjidhet si Deputet në Kuvend, Këshilltar Komunal dhe Kryetar Komune me kusht që ati/asaj... mos t’i jetë dorëzuar vendim përfundimtar gjyqësor për burgim gjatë së paku 6 muajve të kaluar..”

<sup>4</sup> Kundër BDI kishte 10 sulme, kundër PDSH 2 dhe nga një kundër VMRO-DPMNE dhe LSDM.

për të qetësuar situatë e tensionuar ku mbështetësit e BDIs autostradën Tetovë-Shkup dhe morën peng një polic.

Përveç incidenteve që i janë raportuar policisë, OSBE/ODIHR EOM pranuan raporte të shumta nga partitë politike dhe qytetarët për incidente të tjera. Për shembull, BDI denoncoi 24 incidente gjatë fushatës, e shumta e të cilave duket se nuk janë denoncuar para autoriteteve. Pati shumë raporte të tjera për automjete që lëvizin natën vonë nëpër fshatra, që shpeshherë bartnin burra të armatosur, si dhe akuza se Shqiptarë Kosovare ilegalisht kalonin kufirin për të nxitur trazira në ditën e zgjedhjeve.

### **Fushata zgjedhore**

Periodha zyrtare e fushatës zgjati 20 ditë, dhe përfundoi në mesnatë të 30 majit kur filloi heshtja parazgjedhore. Koalicioni VMRO-DPMNE, Koalicioni “Dielli” i LSDM, PDSH dhe BDI organizuan fushatat më aktive dhe të dukshme, duke përdorur afishe, stende afishimi dhe reklama me pagesë. Tubime të shumta u mbajtën gjatë gjithë fushatës, në më të mëdhatë kishte dhjetëra mijëra mbështetës të pranishëm. Aktivitetet e 14 listave tjera të kandidatëve nuk zgjuan shumë interes.

Toni gjatë fushatës ishte nganjëherë i ashpër me sulme dhe akuza personale të cilat rriteshin me përfundimin e fushatës, duke përfshirë edhe disa dyshime ndaj organeve zgjedhore. Në një rast tjetër, si përgjigje ndaj komenteve kritike të partive opozitare në lidhje me rolin e policisë në periudhën parazgjedhore, Ministria për Punë të Brendshme (e cila është edhe bartëse e listës të koalicionit të VMRO-DPMNE në Tetovë) deklaroi se do të paraqes aktpadi për shpifje kundër lideres të LSDM Radmilla Shekerinska për deklaratat e saj rreth paaftësisë të forcave policore.

Fushatat me vizibilitet të lartë që reklamojnë politikën e qeverisë para fillimit të fushatës nxitën kritika nga publiku dhe të njëjtat u ndërpre në më 16 maj. Megjithatë reklamën me pagesë u ndërpre, programet qeveritare siç janë, ekzaminime shëndetësore në hapësira publike, punësime dhe hapje e qendrave shëndetësore në fshatra, vazhduan gjatë gjithë fushatës zgjedhore. Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, deklaroi se kjo praktikë ishte në kundërshtim me Ligjin Kundër Korrupsionit, por Ministri i Shëndetësisë deklaroi se këto aktivitete ishin pjesë e planit vjetor të Qeverisë dhe nuk bie nën ligjin i cili rregullon aktivitetet e qeverisë gjatë periudhës të fushatës zgjedhore.

Një ditë para mbajtjes të zgjedhjeve, u shfaqën afishe në Njësinë zgjedhore 1 të cilat dukej se kishin për qëllim të hutojnë votuesit. Në afisheet u bëhesh thirrje votuesve të votojnë për “Social Demokrat” duke përdorur numrin në fletëvotim të “Partisë Social Demokratë të Maqedonisë” (SDPM) dhe emrin e bartëses të listës të koalicionit “Dielli”, Radmilla. (Emri i bartëses së listës të PSDM në këtë njësi është Rada). LSDM mbajti konferencë për shtyp ku tha se kjo ishte ndërhyrje në fushatën e tyre, dhe KShZ publikisht dënoi këtë veprim si një përpjekje për të manipuluar votuesit. Koha e zgjedhur për këtë veprim ishte me qëllim që çdo reaksion kundër tij të bëhesh gjatë periudhës të heshtjes zgjedhore.

### **Mediat**

Gjatë fushatës, mediat zgjedhësve iu ofruan zgjedhje të gjerë të qëndrimeve politike, duke i dhënë kështu elektoratit mundësinë të informohet dhe të bën zgjedhjen e informuar.

Këshilli për Radiodifuzion zhvilloi monitorimin e mediave elektronike dhe respektimin e ligjeve përkatëse nga ana tyre. Sipas ligjit, ai mund të dërgoj paralajmërime dhe përkohësisht të ndaloj reklamat komerciale. Veç kësaj, Këshilli solli udhëzime të veçanta për qasjen e drejtë të partive politike në mediat gjatë fushatës. Megjithatë, meqenëse ato nuk u miratuan nga Parlamenti para shpërbërjes të tij, nuk kanë fuqi ligjore. Këshilli i lëshoi 2 vërejtje programit MTV2 për "raportim politik mbizotërues për PDSH në programet informative", por nuk u vërejt ndonjë ndryshim si rezultat i këtyre vërejtjeve. Deri sot, Këshilli lëshoi disa vërejtje dhe rekomandime jo-detyruese stacioneve televizive në nivel nacional dhe lokal. Megjithëse Këshilli për Radiodifuzion vërejtji mungesë të baraspeshës në mbulimin informativ të fushatës në MTV 1, nuk solli asnjë sanksionim.

E shumta e partive politike plotësisht shfrytëzuan të drejtën e tyre për kohë pa pagesë në shërbimin radiodifuziv publik. Emetimi pa pagesë ishte në dispozicion në maqedonisht vetëm në MTV1, por jo edhe në programin shqip në MTV2. Të dy kanalet publike gjithashtu organizuan 14 debate maqedonisht dhe shqip. Asnjëri nga liderët e dy koalicioneve, as liderët e PDSH dhe BDI nuk morën pjesë në këto debate, megjithëse liderja e Koalicionit "Dielli" publikisht kërkoi debat me kryetarin e VMRO-DPMNE.

OSBE/ODIHR EOM vëzhguan mediat nga 30 prilli deri në fund të fushatës. Vëzhgimi tregoi mungesë të informimit të barabartë në lajmet nga fushata në të dy kanalet publike MTV-1 dhe MTV-2, të cilët raportimin ia kushtuan kryesisht partive. MTV-1 i kushtoi 24 për qind nga koha e lajmeve kryesore kushtuar zgjedhjeve koalicionit të VMRO-DPMNE, PDSHs 8 për qind dhe Koalicionit "Dielli" 19 për qind. Raportim mbante kryesisht tone pozitive. Anshmëria e kanaleve të televizionit publik u përforcua edhe me raportimin e gjerë për Qeverinë. MTV-1 i kushtoi diku 32 për qind të kohës të lajmeve kryesore për të mbuluar aktivitetet e qeverisë, që mund të thuhet se shkoi përtej kohës të mjaftueshme për raportim nga këto aktivitete.

Kanali publik MTV-2 kryesisht u përqendrua në aktivitetet e partive etnike Shqiptare dhe tregoi një anshmëri të fortë në favor të PDSH të cilës i kushtoi 42 për qind nga koha e lajmeve kryesore mbi zgjedhjet me një ton jashtëzakonisht pozitiv. Nga ana tjetër, partisë opozitare BDI iu dha vetëm 19 për qind të kohës të tillë me një ton kryesisht neutral.

Në stacionet private të monitoruara kishte një dallim të qartë në mënyrën se si mbulonin fushatat. Përderisa A1 dhe Kanal 5 ofruan shikuesve të tyre raportim të balancuar për partitë kryesore politike, TV Sitel ishte qartazi i anshëm në favor të koalicionit të udhëhequr nga VMRO-DPMNE. TV Alsat-M u përqendrua kryesisht në aktivitetet e partive Shqiptare duke favorizuar lehtësisht BDI.

Mediat e shtypura të monitoruara nga OSCE/ODIHR EOM paraqitën një llojllojshmëri qëndrimesh, por shpesh dëshmuuan një politikë redaktuese partiake. Përderisa Vreme, Dnevnik dhe Utrinski Vesnik, ishin në raportimet e tyre në favor të Koalicionit Dielli, Veçeri ishte qartë i anshëm dhe në favor të koalicionit të udhëhequr nga VMRO-DPMNE, dhe i bënte kritika të ashpra Koalicionit "Dielli". Një trend i ngjashëm u vërejt në mediat gazetat në gjuhën shqipe, ku Koha favorizonte PDSH-n ndërsa Lajmi BDI-n.

## **Ankesat dhe apelet**

Pjesëmarrësit elektoral kishin qasje të kufizuar ndaj mjeteve ligjore dhe mundësi për apel për shkeljet e supozuara para ditës të zgjedhjeve, pjesërisht për shkak të mospërputhjes por edhe kuptimit të ngushtë të kompetencave të organeve për ankesa dhe apel (duke përfshirë edhe KShZ). Gjykatësit e gjykatave të instancës së parë dhe të apelit edhe më tej vazhdojnë të mos njohin rolin e tyre në lidhje me shkeljet gjatë fushatave zgjedhore, ndërsa Gjyqi Suprem kufizoi apelet në lidhje me vendimet nga organet zgjedhore duke lejuar vetëm ato që i përmend Kodi.

Në rastin e një apeli të Koalicionit Dielli të udhëhequr nga LSDM kundër regjistrimit të listës së kandidatëve të PSDM, në të cilën femrat e bartësve të listave ishin shumë të ngjashëm me emrat e bartësve të LSDM, Gjykata Supreme refuzoi këtë apel duke thënë se Kodi Zgjedhor nuk parasheh të drejtën për një apel të tillë. Përkundër faktit se më vonë Prokuroria mund të ngrejë padi penale kundër udhëheqësish të PSDM për falsifikim dhe paraqitje të rrejshme, emrat e kandidatëve mbetën në fletëvotim.

Ka numër të vogël të ankesave që nuk janë zgjedhur dhe kanë të bëjnë me ditën e zgjedhjeve. OSBE/ODIHR do të vazhdoj të vëzhgoj proceset në lidhje me ankesat dhe apelet.

### **Përfaqësimi i grave**

Kodi Zgjedhor parasheh që çdo vend i tretë në listën e kandidatëve të plotësohet me një grua. Partitë politike respektuan këtë kusht; nga 1,540 kandidat, 35 për qind ishin gra. Gjithashtu vërehet një rritje e barazisë gjinore në administratën zgjedhore. Në 30 KKZ më se gjysma e anëtarëve janë femra. Në të gjitha KKZ tjera, së paku 30 për qind janë femra. Afro 40 për qind të KKZ kryesohen nga femra. Monitorimi i mediave nga OSBE/ODIHR tregoi se në pesë nga gjashtë televizionet nacionale mesatarisht 7 - 15 për qind i raportimin iu kushtua kandidateve femra. Por, Kanal 5 u dallua me 50 për qind të raportimit në lajme kushtuar kandidateve femra.

### **Komunitetet e tjera etnike**

Për veç komunitetit shqiptar, komunitete të tjera etnike janë: Turqit, Serbët, Romët, Vllahët dhe Boshnjakët. Ata janë të përfaqësuar nga disa parti politike etnike. Pjesëtarët e komuniteteve tjera përpiqen të luajnë një rolë më të rëndësishëm në përpjekjet për të zgjeruar dialogun nacional përtej debatit dy nacional mes Maqedonasve etnik dhe Shqiptarëve etnik. Në këtë drejtim, 6 nga këto parti iu bashkëngjitën koalicioneve më të mëdha për të përmirësuar pozitën e tyre politike.

### **Grupet vëzhguese vendore**

Dhjetë grupe vëzhguese jashtë partiake nga vendi regjistruan pranë KShZs 4,892 vëzhgues: grupi më i madh i vëzhguesve ishte organizata MOST me 3,500 vëzhgues të regjistruar. Ata ishin të pranishëm në 65për qind të vendvotimeve që i vizituan vëzhguesit e OSBE/ODIHR EOM. Më tek, partitë politike dërguan numër të madh vëzhguesish në teren në ditë e zgjedhjeve.

Për shkak të shqetësimit rreth sigurisë MOST tërhoqi 89 vëzhgues nga Tetova, Gostivari dhe rrethinën e gjerë të Shkupit. Më tej, 11 vëzhgues u përjashtuan me force nga vendvotimi në rajonin e Tetovës.



MOST zhvilloi prezantim tabelor paralel natën pas zgjedhjeve në 30% të vendvotimeve për të verifikuar saktësinë e rezultateve të përcaktuara nga administrata zgjedhore. Për shkak të parregullsive, MOST nuk dha rezultate paralele tabelore për Njësinë zgjedhore një dhe gjashtë.

### **Dita e zgjedhjeve dhe numërimi i votave**

Gjatë ditës të zgjedhjeve, dhuna dhe përdorimi i armëve të zjarrit mbizotëroi në disa komuna në veri dhe perëndim të vendit. Një person u plagos për vdekje në një incident në Haraqinë, ndërsa gjatë gjithë ditës të zgjedhjeve kishte disa të lënduar. Në Gostivar, dy vendvotime u mbyllën kur kutitë e votimit u vodhën nga persona të armatosur dhe të gjithë anëtarët e KZs u larguan me forcë nga VV. Votimi gjithashtu u mbyll në mëngjes në komunën Çuçer-Sandevo në mëngjes kur afërsisht 30 persona të panjohur hynë në VV, u kërcënuan anëtarëve të KZ dhe vodhën materialin zgjedhor. Në dy incidente të ndara, vëzhguesit e MNVZ dhe dy anëtarë të KKZ u nxorën nga VV me anë të policisë (Haraqinë dhe Poroj). Dhuna u dënua nga Presidenti Branko Crvenkovski. Gjatë pasdites, situata deri diku u stabilizua, me më pak incidente të dhunshme dhe me prani policore më të dukshme.

Kryeministri Gruevski paralajmëroi se do të zhvillohen rivotime në vendet ku ka pasur incidente të dhunshme. KKZ deklaroi se do të anuloi rezultatet në sërë paku 22 VV, përfshi këtu 8 VV në Haraqinë, dhe shtroi mundësinë për anulime të tjera.

Megjithëse hapja e VV u vlerësua kryesisht në mënyrë pozitive, procesi i votimit ishte më pak pozitiv, dhe u vlerësua si i keq ose shumë i keq në 8 për qind nga votimi i vëzhguar. Ky vlerësim negativ ishte në mënyrë disproporcionale i lartë në shumë rajone etnike shqiptare. Votimi u vlerësua si i keq ose shumë i keq në 21 për qind të rajoneve nën vëzhgim ( për kundër rajoneve etnike maqedonase ku u vlerësuan negativisht në 2 për qind). Megjithëse votimi u zhvillua në rrethana kryesisht të qeta, u vërejtën tensionime dhe trazira në 3 për qind të VV të vizituara mbarë vendit. Në rajonet të banuara me shumicë shqiptare, numri arriti 9 për qind.

Ditën e zgjedhjeve u vërejtën disa gabime procedurale. U vërejtën raste të votimit familjar (18 për qind) të cilat shënojnë rritje në rajone të banuara me shumicë shqiptare (35 për qind). Probleme të tjera serioze ishin: votimi i disahershëm (11 raste), mbushja e kutive (30 raste), dhe votimi për tjetër (41 raste). U vërejtën kërcënime në 18 raste, përfshi këtu edhe sulme fizike mbi anëtarë të KZ. Në 9 për qind të VV të vizituara u vërejt prania e personave të paautorizuar, dhe në 1 për qind të VV ata ndërhyjnë dhe drejtonin procesin. U vërejt mungesa e policisë në shumë VV gjatë votimit (22 për qind), që ishte kundërligjore.

Numërimi i votave u vlerësua si “i keq” ose “shumë i keq” në 15 për qind të VV të vizituara, me një dallim të konsiderueshëm mes rajoneve të banuara kryesisht me Shqiptarë (32 për qind) dhe pjesë të tjera të vendit (9 për qind). Problemet gjatë votimit ishin: prania e personave të paautorizuar (16 për qind), frikësimi i anëtarëve të KZve (7 për qind) dhe gabime në shënimin e numrave (15 për qind).

Vëzhguesit e MNVZ mbikëqyrën paraqitjen tabelore në 71 nga 84 KKZ. Procesit i përgatitjes tabelore të rezultateve u vlerësua si “i mirë” dhe “shumë i mirë”, në të gjitha KKZ përveç në dy. Në përgjithësi, përgatitja tabelore u zbatua në mënyrë të rregullt dhe transparente, me

përfaqësues dhe vëzhgues jo partiak të autorizuar të pranishëm në të gjitha KKZ. Megjithatë, kompjuterizimi i rezultateve u zhvillua në një dhomë të veçantë, dhe vetëm vëzhguesve të MNVZ iu lejua të përcjellin procesin e digjitalizimit të të dhënave. Raporti i vetëm për falsifikim të rezultateve ishte për KKZ të Tetovës, ku gjatë ditës kishte probleme të shumta.

KShZ deklaroi se pjesëmarrja në zgjedhje ishte 58 për qind. Nga rezultatet nga 2,741 VV të paraqitura në mënyrë tabelore në bazën e të dhënave të KShZ, në 75 ka numra për dalje tepër të madhe. Në dy vendvotime në Poroj, për shembull ka 99 deri 100 për qind dalje dhe pothuajse të gjitha votat janë për PDSH.

*Ky dokument është në dispozicion Maqedonisht dhe Shqip.  
Megjithatë, versioni anglisht mbetet dokumenti vetëm zyrtar*

---

#### INFORMACIONE PËR MISIONIN DHE FALËNDERIME

---

OSBE/ODIHR hapi misionin vëzhgues në Shkup më 30 prill 2000 me 11 ekspert, dhe më vonë rritin numrin në 13, dhe 20 vëzhgues afatgjatë të vendosur në kryeqytet dhe mbarë vendit. Në ditën e zgjedhjeve, 289 vëzhgues të përkohshëm vëzhguan në kuadër të një Misioni Ndërkombëtar për Vëzhgimin e Zgjedhjeve (IEOM), përfshi këtu edhe një delegacion 19-anëtarësh nga Asambleja Parlamentare e OSBE (AP OSBE) dhe një delegacion 13-anëtarësh nga Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës (PACE) dhe 214 vëzhgues të OSBE/ODIHR. Gjithsej, kishte vëzhgues, nga 42 vendet pjesëmarrëse të OSBEs. IEOM vëzhgoi votimin në mbi 1100 dhe numërimin e votave në 111 vendvotime mbarë vendit (nga 2976 vendvotime mbarë vendit) dërgimin e rezultateve deri te KKZ dhe përgatitjen tabelore në 71 KKZ pas mbylljes të vendvotimeve

Znj. Pia Christmas-Møller (Danimarkë), nënkryetare e Asamblesë Parlamentare dhe vëzhguese e përkohshme e OSBEs. Z. Mevlüt Çavuşoğlu (Turqi) kryesoi delegacionin e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës. Ambasadori Robert Barry është Shefi i Misionit Vëzhgues të OSBE/ODIHR.

IEOM dëshiron të falënderoj Ministrinë e Jashtme për ftesën të vëzhgoj zgjedhjet, Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve për dhënien e akreditimeve, dhe autoriteteve të tjera lokale dhe shtetërore dhe lokale për ndihmë dhe bashkëpunimin. IEOM gjithashtu dëshiron të shpreh falënderimin e tij Misionit të OSBE në Shkup për mbështetjen e tyre gjatë gjithë misionit, si dhe ambasadat rezidente të vendeve pjesëmarrëse në OSBE dhe institucione të tjera ndërkombëtare për bashkëpunimin dhe mbështetjen e tyre.

#### **Për më tepër informacione, ju lutemi kontaktoni:**

- Z. Jens-Hagen Eschenbacher, OSBE/ODIHR zëdhënës, në Varshavë (+ 48 22 520 0600), ose z. Drew Mr. Hyslop, OSBE/ODIHR Këshilltar për zgjedhje, në Varshavë (+ 48 22 520 0600);
- Z. Andreas Baker, këshilltar i presidentit, Sekretariat Ndërkombëtar i AP OSBE, në Kopenhagë (+45 60 10 83 80);
- Z. Vladimir Dronov, Shef i Sekretariatit, Bashkëpunim Ndërparlamentar dhe Vëzhgim i Zgjedhjeve, PACE (+33388412709).

---

#### **Adresa e OSCE/ODIHR EOM (deri më 13 qershor 2008):**

46, rruga Gjuro Gjakovic, Shkup 1000  
tel.: +389 2 3290119  
faks: +389 2 3290963  
email: [office@odihr.org.mk](mailto:office@odihr.org.mk)